

Tiranë, më 05.02.2022

KA-02
DT. 05.02.2022

ANKIM

019
12:45

ANKUES:

Partia Demokratike e Shqipërisë, me seli në adresën: Blv. Zhan d' Ark Nr. 11, Tiranë, përfaqësuar nga **Marash LOGU**, me email: marash.logu@parlament.al dhe nr.cel: (+355) 67 48 25 149.

OBJEKTI:

Shfuqizimi i vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

BAZA LIGJORE:

Nenet 21, 64, 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor;
Nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”;
Vendimi nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

DREJTUAR:

KOMISIONIT TË ANKIMEVE DHE SANKSIONEVE

Të Nderuar,

Në 4 Shkurt 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur “1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendosre për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, Koalicionin e partive politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë.”

Pasi jemi njohur me dispozitivin dhe arsyetimin e këtij vendimi, cmojmë se vjen në kundërshtim me nenet 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor, nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendimin nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator. Prandaj, bazuar në nenin 21 të Kodit Zgjedhor, i drejtohem Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për arsyet si më poshtë:



I. RRETHANAT E CËSHTJES

1. Në datën 03.02.2022, ora 18:41, jemi njoftuar në rrugë elektronike nga administrata e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (në vijim “KQZ”) për zhvillimin e mbledhjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ditën e premte, datë 04.02.2022, ora 12:30, me rend dite, ndër të tjera, “Shqyrtim i projektvendimeve: 3. Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SHL) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022. Ndryshe, nga praktika e mëparshme e punës, në komunikimin elektronik nuk ndodhej asnjë material/dokument/projektvendim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

2. Në këto kushte, në seancën e datës 04.02.2022, përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka kërkuar paraprakisht të njihet zyrtarisht me kërkesën për regjistrimin e koalicionit dhe dokumentacionin bashkëlidhur saj. Pas një diskutimi të shkurtër, administrata e KQZ-së i ka vendosur në dispozicion përfaqësuesit dokumentacionin e kërkuar. Nga një shqyrtim i kryer në sallën e mbledhjeve të KQZ-së, janë konstatuar dy elemente, të cilat në vlerësimin tonë e bënin kërkesën në kundërshtim me ligjin, e për rrjedhojë Komisioneri duhet të vendoste rrëzimin e saj. Këto elemente, të cilët do të trajtohen më gjërësisht në pjesën e analizës ligjore, i janë paraqitur Komisionerit.

3. Me vendimin nr. 46, datë 04.02.2022, Komisioneri ka vendosur t’i japë të drejtë përfaqësuesit të PD-së vetëm pjesërisht sa i përket faktit që në kërkesë, në pjesën e përbërjes së koalicionit përmendej edhe një “subjekt” me emërtimin “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit”, i cili nuk ishte i regjistruar si subjekt zgjedhor dhe përfshirja e tij në koalicionin “Shtëpia e Lirisë”, vinte në kundërshtim me nenin 66 të Kodit Zgjedhor. Megjithëse, kërkesa dhe marrëveshja bashkëlidhur saj, mbeteshin të pandryshuara, me një element paligjshmërie të konstatuar nga vetë Komisioneri, ai ka vendosur regjistrimin e koalicionit si subjekt zgjedhor.

II. BAZA LIGJORE

4. Kodi Zgjedhor:

(i) Neni 65 parashikon se: “1. Dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ, sipas nenit 64 të këtij Kodi, mund të regjistrohen në KQZ si koalicion zgjedhor në shkallë vendi jo më vonë se 60 ditë përpara zgjedhjeve. 2. Partia politike pjesëmarrëse në një koalicion nuk mund të marrë pjesë në një koalicion tjetër dhe as të paraqesë kandidatë apo listë shumëemërore kandidatësh jashtë koalicionit ku ajo bën pjesë. 3. Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe



detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet në KQZ.”

5. Udhëzimi nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”:

(i) Neni 2 parashikon se “1. Në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara në nenin 65, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, subjektet zgjedhore paraqesin kërkesën për t’u regjistruar si koalicion zgjedhor në KQZ. Në momentin e depozitimit të kërkesës, koalicioni, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit dhe depoziton, njëkohësisht, edhe marrëveshjen e koalicionit. 2. Marrëveshja duhet të përmbajë, të paktën: a) shprehjen e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesëtare e koalicionit; e) numrin e kandidatëve që duhet të propozojë secila parti politike brenda koalicionit për çdo zonë zgjedhore.”.

6. Vendimi nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”:

(i) Pika 9 parashikon se: “Koalicionit zgjedhore duhet të paraqesin kërkesën për regjistrimin si koalicion për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Vorë, Durrës, Dibër, Rrogozhinë dhe Lushnjë në KQZ brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga miratimi i të gjitha kërkesave për regjistrimin e partive politike dhe komiteteve nismëtare. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton kërkesën për regjistrim si koalicion brenda 24 (njëzet e katër) orëve.”

III. ANALIZA LIGJORE

A. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit

7. Me shkresën nr. 435 prot., datë 31.01.2022, Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur kërkesën me objekt “Kërkesë për regjistrimin në KQZ të koalicionit zgjedhor”. Bashkëlidhur kësaj kërkesë gjendet autorizimi për Z. Endrit Braimllari dhe marrëveshja e koalicionit. Ndërsa, me vendimet nr. 34 dhe nr. 38, datë 02.02.2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur regjistrimin e subjekteve zgjedhore Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokratiane. Nga sa më sipër, del qartë se në momentin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim si koalicion zgjedhor, asnjëra prej dy partive politike pjesëmarrëse në këtë koalicion, nuk ishin regjistruar si subjekte zgjedhore.

8. Neni 65, pika 1 e Kodit Zgjedhor, ashtu si edhe neni 2 i Udhëzimit nr. 1/2020 të Komisionerit, përcakton qartë se si koalicion zgjedhor mund të regjistrohet vetëm dy ose më shumë parti politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në KQZ. Ndërsa, pika 9 e vendimit nr. 2, datë

22.01.2022 të Komisionit Rregullator kishte parashikuar qartazi që kërkesa për regjistrimin e koalicionit zgjedhor paraqiten brenda 24 orëve nga miratimi i kërkesave për regjistrimin e partive politike. Ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, nuk njohin koncepte të tilla si “përpara afatit”, por vetëm brenda afatit apo jashtë afatit.

9. Duke u kthyer te rasti konkret, rezulton se kërkesa e paraqitur nga Lëvizja Socialiste për Integrim vjen në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara, pasi në momentin e paraqitjes, LSI i mungonte cilësia e subjektit zgjedhor, cka do të thotë se as ajo dhe as partia tjetër politike (PDK) nuk legjitimoheshin për paraqitjen e kësaj kërkesë. Në vendimin nr. 46, datë 04.02.2022, Komisioneri, megjithëse pranon se në datën 03.02.2022 që ishte afati ligjor për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e koalicioneve nuk është paraqitur asnjë kërkesë, vendos regjistrimin e këtij koalicioni, duke shpikur një terminologji të re, pa referencë në legjislacionin shqiptar, kërkesë e paraqitur “përpara afatit”.


10. Në fakt, është e qartë se nga ana procedurale, kjo kërkesë rezulton me dy të meta, të cilat do të mjaftonin për të vendosur mosregjistrimin e këtij koalicioni zgjedhor. Nga njëra anë, kërkesuesit i mungonin legjitimitimi si subjekt zgjedhor në momentin e paraqitjes së kërkesës, dhe nga ana tjetër, kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Pretendimi i Komisionerit se kërkesa u konfirmua nga përfaqësuesi i LSI-së është gjithashtu i pabazuar, sepse edhe sikur ta marrim të mirëqenë këtë konfirmim, ai është bërë në datën 04.02.2022, pra jashtë afatit 24 orë pas regjistrimit të partive politike. Në kushtet kur kërkesa është paraqitur jashtë afatit dhe kërkesuesit i mungonte legjitimitimi, ne vlerësojmë se ajo duhet rrëzuar si e pabazuar.

B. Në lidhje me përmbajtjen e kërkesës dhe marrëveshjes

11. Megjithëse, cmojmë se argumentet e paraqitura më lart janë të mjaftueshme për rrëzimin e kësaj kërkesë, në këtë pjesë do të ndalemi në ligjshmërinë e përmbajtjes së kërkesës dhe marrëveshjes së koalicionit. Konkretisht, në faqen e parë të kërkesës thuhet “*Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” (LSI-PD Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit-PDK).*”; në faqen e dytë vijon: “*Partitë përbërëse të koalicionit janë: “Lëvizja Socialiste për Integrim; Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit; Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit; Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit.*” (shih fq. 1); “*Partitë e Koalicionit, firmëtare të kësaj marrëveshje, janë “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit; nënshkruar nga Z. Flamur Noka”* (shih fq. 2-3).

12. Neni 65, pika 1 e Kodit Zgjedhor, sic me të drejtë arsyeton edhe Komisioneri në vendimmarrjen e tij, përcakton tre kushte për regjistrimin e një koalicioni zgjedhor: 1. Koalicioni formohet vetëm nga parti politike. 2. Partia politike të jetë e regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ. 3. Numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë.

4




Kuptohet që të tre këto kushte janë kumulative dhe pranimi i një kërkesë për regjistrim koalicioni kërkon përmbushjen e njëkohshme të tyre. Në rastin konkret, rezulton se njëra nga subjektet pjesëmarrëse të koalicionit nuk është parti politike, përkatësisht subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit”, rrjedhimisht ky subjekt nuk ishte i regjistruar as në KQZ si subjekt zgjedhor. Kaq do të mjaftonte në fakt që Komisioneri të vendoste rrëzimin e kërkesës për koalicionin “Shtëpia e Lirisë”.

13. Por, ndryshe nga sa arsyeton Komisioneri, që përpiqet ta trajtojë marrëveshjen e koalicionit si një dokument formal, Kodi Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, imponojnë detyrimin edhe të verifikimit të përputhshmërisë së përmbajtjes të marrëveshjes me ligjin. Konkretisht, një nga kërkesat kryesore të nenit 65 të Kodit dhe nenit 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 është shprehja e qartë e vullnetit të partive pjesëmarrëse për të qenë pjesë e një koalicioni zgjedhor. Në përmbajtje të kërkesës dhe marrëveshjes ka referenca të qarta ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila për asnjë moment dhe në asnjë rast nuk ka shprehur vullnetin apo dëshirën për të qenë pjesë e një koalicioni të tillë. Një shprehje e tillë vullneti mund të bëhej vetëm nga kryetari i saj, Z. Lulzim Basha apo përfaqësuesit e autorizuar nga ana e tij, sic është përcaktuar në vendimin nr. 33, datë 02.02.2022 për regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor.

14. Mungesa e këtij elementi thelbësor, pra shprehja e vullnetit nga subjekti zgjedhor për të qenë pjesëmarrës në një koalicion zgjedhor, e bën marrëveshjen të paligjshme dhe imponon detyrimin për KQZ që të refuzojë regjistrimin e saj. Megjithëse, ky element paligjshmërie është konstatuar edhe nga ana e vetë Komisionerit, ai ka vendosur pranimin e kërkesës dhe regjistrimin e saj, duke ndërhyrë dhe ndryshuar vullnetin e kërkuarit. Pra, ndryshe nga sa thuhet në kërkesë për subjektet pjesëmarrëse në koalicionin zgjedhor, Komisioneri ka vendosur regjistrimin e një koalicioni vetëm me dy prej tyre, duke vepruar në fakt në tejkalim të kompetencave të tij. Ligji zgjedhor dhe aktet nënligjore autorizojnë Komisionerin vetëm të vendosë pranimin apo rrëzimin e një kërkesë, por jo të ndërhyjë në përmbajtjen e saj apo të marrëveshjes së koalicionit për ta sjellë në formën që ai gjykon se është në përputhje me ligjin.

15. Një tjetër element paligjshmërie në këtë marrëveshje koalicioni është edhe mungesa e përcaktimit të numrit të kandidatëve që duhet të propozojë secila parti politike brenda koalicionit për çdo parti zgjedhore (shih nenin 2, pika 2, gërma “e” e Udhëzimit nr. 1/2020 të Komisionerit). Ky element është vecanërisht i rëndësishëm pasi në faqen e parë të marrëveshjes thuhet se drejtuese politike është Partia Demokratike e Shqipërisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, ndërkohë që në media kanë qarkulluar deklarata nga përfaqësues të Lëvizjes Socialiste për Integritet, se kandidatët do të vijnë nga rradhët e subjektit “Komisioni i Rithemelimit”. Në kushtet kur Komisioneri ka vendosur që të përjashtojë subjektin “Komisioni i Rithemelimit” nga marrëveshja e koalicionit, cili do të jetë subjekti apo partia politike që do të propozojë kandidatët



për kryetar bashkie. Marrëveshja nuk e thotë dhe as vendimmarrja e Komisionerit nuk jep përgjigje.

16. Këto paqartësi në vendimmarrjen e Komisionerit, në fakt janë reflektuar edhe në publik, pasi individë të caktuar, që pretendojnë se janë kandidatë të subjektit “Komisioni i Rithemelimit”, zhvillojnë takime me emër dhe logo të njëjta me ato të Partisë Demokratike (foto bashkëlidhur), duke prodhuar një konfuzion për zgjedhësit, që nenin 66 i Kodit Zgjedhor përpiqet ta eliminojë, në mënyrë që zgjedhësi të jetë shumë i qartë në momentin e votimit lidhur me partinë dhe kandidatin që ai dëshiron të votojë. Argumentet e mësipërme provojnë qartë se në tërësinë e saj, kërkesa dhe marrëveshja e depozituar nga Lëvizja Socialiste për Integrim janë në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe aktet nënligjore, dhe si të tilla duhen rrëzuar.


IV. KONKLUZIONI

17. Kërkesa e paraqitur në datën 31.01.2022 nga Lëvizja Socialiste për Integrim, në kushtet kur kjo e fundit dhe as subjektet e tjera të përmendura në kërkesë, përkatësisht Partia Demokratiane dhe Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, nuk ishin regjistruar si subjekte zgjedhore, është në kundërshtim me kërkesat e nenit 65 të Kodit Zgjedhor që përcakton se një koalicion mund të formohet vetëm ndërmjet partive politike që kanë fituar cilësinë e subjektit zgjedhor. Në këtë kuptim, kërkesave iu mungon legjitimitimi për paraqitjen e kësaj kërkesë. Nga ana tjetër, pika 9 e vendimit nr. 2, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, ka përcaktuar qartë afatin për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e koalicioneve, 24 orë pas miratimit të kërkesave të partive politike, që përkon me datën 03.02.2022. Në këtë datë, asnjë subjekt zgjedhor nuk ka paraqitur kërkesën për regjistrim si koalicion zgjedhor. Në këtë kuptim, kjo kërkesë është bërë jashtë afatit ligjor.

18. Kërkesa dhe marrëveshja referojnë te një subjekt “Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit”, i cili jo vetëm nuk është i regjistruar si subjekt zgjedhor, por as nuk rezulton të ekzistojë si parti politike. Nga ana tjetër, kërkesa dhe marrëveshja përmbajnë referenca te Partia Demokratike e Shqipërisë, në kushtet kur kjo e fundit as nëpërmjet kryetarit të saj apo ndonjë personi tjetër të autorizuar nga ana e tij, nuk ka shprehur vullnetin për të qenë pjesëmarrëse në këtë koalicion. Marrëveshjes i mungon edhe një element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me përcaktimin e numrit të kandidatëve nga secila parti politike. Në kushtet kur subjekti “Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit” është përjashtuar nga marrëveshja, mbetet e paqartë se cila parti politike do të propozojë kandidatët e koalicionit.

19. Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në nenin 64, 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor, nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe vendimin nr. 02, datë 22.01.2022 të Komisionit Rregullator, përfundimisht,

6



KËRKOJMË:

- Shfuqizimin e vendimit nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, (SH-L) për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”.

Me konsideratë,

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Marash LOGU

